



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, më 02.11. 2010, në orën 14:30, sala N-10
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Kolë Berisha, Besa Gaxheri, Fatmire Berisha, Ramadan Gashi, Ahmet Isufi, Riza Smaka, Vladimir Todoroviq dhe Đezair Murati.

Mungoi: Riza Smaka

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri dhe Advie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni – Kaloshi, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.10.2010,
3. Interpretimi i dispozitave (neneve 57.1, 69.3.4 dhe shtojcës së dytë, pikës 12 të Rregullores së Kuvendit).
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Interpretimi i dispozitave (neneve 57.1, 69.3.4 dhe shtojcës së dytë, pikës 12 të Rregullores së Kuvendit).

Kryetari Hyseni ua përkujtoi anëtarëve se në mbledhjen e fundit është debatuar sipas kërkesës së Kryesisë së Kuvendit, se Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barzi Gjinore, Përsosur dhe Peticione, është Komision i përhershëm apo funksional? Komisioni në mbledhjen e fundit nuk arriti që të bëjë interpretimin përfundimtar, e angazhoi grupin punues në krye me kryetarin e Komisionit (Hysenin) dhe Njësinë mbështetëse që ta përpunojë interpretimin e dispozitave të kërkuara.

Teksti i rekomandimit është përgatitur dhe shpërndarë me kohë.

Në vazhdim kryetari i Komisionit e propozoi rekomandimin për debat dhe miratim, të cilin e kishte hartuar grupi punues, e që ishte shpërndarë me kohë.

Pas diskutimit të të gjithë deputetëve, Komisioni e miratoi rekomandimin si vijon:

- Rregullorja e Kuvendit të Kosovës nuk e sqaron shprehimisht dhe tërësisht dilemën nëse Komisioni për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione është Komision i përhershëm, ose është Komision funksional, andaj mbetet në kompetencë të Kuvendit, që gjatë zbatimit të neneve 57.1 dhe 57.6 të Rregullores të vendosë se: Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjnor, Persona të Pagjetur dhe Peticione trajtohet apo jo, si Komisioni i përhershëm?
- Komisioni vlerëson se pasi deri me tani Kuvendi, e ka ngarkuar Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione si Komision të përhershëm, Kryesia e Kuvendit, në pajtim me nenin 15 të Rregullores, mund ta trajtojë këtë komision për të kaluarën si Komision i përhershëm, ndërsa, për të ardhmen dilema e shtruar duhet të rregullohet me Rregullore në kuadër të konceptit të ri për strukturimin e komisioneve për legjislaturën e ardhshme.

4. Të ndryshme:

Kryetari Hyseni falënderoi anëtarët e Komisionit, si dhe Stafin mbështetës për angazhimin dhe mbështetjen e punës që është bërë në realizimin e Planit të gjertanishëm të punës së Komisionit.

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Hydajet HYSENI - KALOSHI